



Inspektorati i Tregut i Kosovës

Trupi Koordinues për Mbikqyrjen e Tregut në Kosovë

Në bazë të nenit 24 , paragrafet, të Ligjit për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit (Nr. 04/L-39), Trupi Koordinues për Mbikqyrjen e Tregut, në bazë të raporteve vjetore të autoriteteve të mbikqyrjes së tregut, përgaditi:

## **RAPORTIN E RALIZIMIT**

### **TE PROGRAMIT TE PËRGJITHSHËM TE MBIKËQYRJËS SË PRODUKTEVE NE TREG PËR VITIN 2017.**

Organi koordinues për mbikqyrjen e produkteve në treg, në përputhje me kompetencat e Ligji për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, shqyrtoi raportet e autoriteteve të mbikqyrjes së produkteve në treg, në zbatimin e programeve sektoriale që janë pjesë e Programit të Përgjithshëm të Mbikqyrjes së Produkteve në Treg, dhe i konsolidoi ato në një raport vjetor mbi realizimin e programit të përgjithshëm të mbikqyrjes së produkteve në treg .

Monitorimi i tregut gjatë periudhës raportuese u organizua sipas Programit të Përgjithshëm të Mbikqyrjes së Produkteve në Tregë (monitorim proaktiv) dhe informacionit nga sistemi për shkëmbimin e shpejtë të informacionit në Bashkimin Evropian për produktet e rrezikshme (sistemi RAPEX), informacionit nga burime tjera rrjeti për shkëmbimin e informacioneve për produkte të rrezikshme, me kekesë të Administratës Doganore , si dhe me parashtesë të klientit (kontrolli reaktiv).

Mbikqyrja e tregut është kryer në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Sigurinë e Produkteve të Përgjithshme (Nr. 04/L-78), Ligji për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit (Nr. 04/L-39), Ligjit për përdorimin civil të eksplozivëve, (Nr. 04/L-022), Ligjit për pajisjet nën presion (Nr. 02/L-103) dhe ligjeve të tjera të veçanta, aktet nënligjore (rregulloret) dhe standardet e vlefshme për grupet e monitoruara të produkteve.

Në zbatimin e Programit të Mbikqyrjes së Përgjithshme të Produkteve në Treg në vitin 2017, jane planifikuar te marrin pjesë katër autoritete inspektuese, në kuadër të Trupes Koordinuese për Mbikqyrje të Tregut, (Inspektorati i tregut (MTI), Inspektorati i Energjisë për Pajisje nën Presion (MZHE), Inspektorati nacional për substancat eksplozive, substancat e ndezëshme (MPB), ndërsa Inspektorati shëndetsorë-farmaceutik nuk ka marrë pjesë në zbatimin e programit të monitorimit të mbikqyrjes së planifikuar për arsye të mungesës së mandatit ligjor që të kryej zbatimin e monitorimit në fushën e sigurisë së produkteve, respektivisht në zbatimin e mbikqyrjes së sigurisë së lodrave në treg.

Në realizimin e Programit të Monitorimit të Produkteve të Përgjithshme në treg, që përfshinte 6 produkte, kanë marrë pjesë tre autoritete inspektuese, nga të cilat (Inspektorati i Tregut, Inspektorati i Energjisë për Pajisje nën Presion dhe Inspektorati Nacional për Substancat Eksplozive, Substancat e Ndezëshme)

Programi i përgjithshëm i mbikqyrjes së produkteve në treg për vitin 2017, përfshinë 6 produkte: drita dekoruesë – (shirita ndriçues ) për festat e fundvitit, kablllo vazhduese, lodra ( kufizimet për moshën), veshje për fëmijë me lidhësa-shirita, rezervar gasi (gln-së), fishekzjarre-artikujt piroteknikë.

Inspektimet u kryen përmes kontrollit të dokumenteve mbështetëse, ekzamnimit vizual dhe me vlerësim të rrezikut.

Në vitin raportues u kryen gjithsej 320 inspektime, nga të cilat 201 inspektime janë kryer në mbikqyrje proaktive dhe 119 inspektime në mbikqyrjen reaktive ( me njoftime të RAPEX-it; 91, sipas informatave të inspektorit nga mbikqyrja nje (1), me kerkesë nga Administrata Doganore 26 dhe nje (1) me parashtesë të klientit).

**Tabela nr. 1 – Numri i inspektimeve të kryera nga autoritetet inspektuese (Trupi koordinues)**

Autoritetet e përfshira	IT (MTI)	ISH-F (MSH)	IE (MZHE)	INSSHSN (MPB)	DAM (MIT)	IPMM (MMPH)	IP (MPMS)	Totali
Inspektime e përgjithshme te kryera	266	-	32	22	-	-	-	320
<b>Monitorimi proaktiv</b>	<b>151</b>	-	<b>30</b>	<b>20</b>	-	-	-	<b>201</b>
a) nga plani	150	-	30	20	-	-	-	200
b) nga plani i zgjeruar	1							1
<b>Monitroimi reaktiv</b>	<b>115</b>	-	<b>2</b>	<b>2</b>	-	-	-	<b>119</b>
a) raporte nga rapex-i	91	-	-	-	-	-	-	70
b) njoftim nga inspektori	1	-	-	-	-	-	-	21
c) parashtrësë te klientit	1	-	-	-	-	-	-	1
e) njoftim nga dogana	22	-	2	2	-	-	-	26

(IT)-Inspektorati i tregut -sektori për sigurinë e produkteve,

(ISH-F)-Inspektorati shëndetsorë-farमाocetik,

(IE)-Inspektorati i energjisë për pajisje nën presion,

(DSP)-Inspektorati nacional për substancat eksplozive dhe substancat e ndezëshme,

(DAM)-Departamenti i automjeteve motorike,

(IPMM)-Inspektorati për mbrojtje të mjedisit

(IP)-Inspektorati i punës dhe;

(ADK)-Administartara e doganës së Kosovës.

### 1. Produktet e rrezikshme të gjetura në treg

Në tregun e Kosovës, në monitorimin proaktiv dhe reaktiv, u gjetën 9 lloje të produkteve të rrezikshme në vitin raportues, në sasinë prej 3.439 copë.

**Tabela nr. 2 - Numri i produkteve të rrezikshme të gjetura në treg - gjithsejt**

Emri i produktit	Autoritetit që ka kryer mbikëqyrje	Lloji i produktit	Importuara (copë)	Në treg (copë)	Te shitura	Produkte me rrezik serioz (copë/ lloje)	Produkte, jo me rrezik serioz (copë/lloj)	Lloji i masave
Peme dekorative	IT	4	901	901	-	901/4	-	d
Drone fluturues	IT	1	10	8	2	8/1	-	d
Kabell vazhdues	IT	1	21	21	-	21/1	-	d
Vlues elektrike-per gatime	IT	1	16	16	-	16/1	-	d

Disqe per prerje metali-betoni	IT	1	1.950	1.553	397	-	1.553	d
Drita dekoruese	IT	1	940	940	-	940/1	-	d
<b>Gjithseje</b>		<b>9</b>	<b>3.838</b>	<b>3.439</b>	<b>399</b>	<b>1.886</b>	<b>1.553</b>	<b>3.439</b>

### 1.1 Monitorimi proakti

#### Monitorimi proaktiv u krye në bazë të programit të përgjithshëm të mbikëqyrjes së produkteve në treg për vitin 2017.

Bazuar në programin e monitorimit të produkteve në treg në vitet e mëparshme, është kryer mbikëqyrja e zgjeruar. Sipas Programit të përgjithshëm të monitorimit të produkteve për vitin 2017, në treg u identifikuan 9 llojë në sasinë prej 3.439 copë produkte.

Nga ky numer 8 llojë në sasinë prej 1.886 copë produkte të rrezikshme me rrezik serioz, ndërsa 1 llojë në sasinë prej 1.553 copë produkte që nuk paraqesin një rrezik serioz ( produktet pa dokumentacion mbeshtetës).

Në mbikëqyrjen e zgjeruar e cila u krye në bazë të programit të monitorimit të produkteve nga vitet e mëparshme, në treg u gjetë 1 llojë në sasinë prej 8 cope produkte të rrezikshme. Prej numrit të mësipërm 8 llojë në sasi prej 1.886 copë, janë produkte të rrezikshme me rrezik serioz, ndërsa një llojë në sasi prej 1.553 copë, produkte që nuk paraqesin një rrezik serioz ( pa dokumentacion mbeshtetës).

#### Tabela nr. 3 -Struktura e produkteve të rrezikshme që gjenden në treg nën programin e përgjithshëm të mbikëqyrjes së tregut

Kategoria	Emri i organit që ka kryer kontrollin	Lloji i produktit	Importuar (cope)	Në treg	I shitur
Peme dekorative	IT	4	901	901	-
Pajisje elektrike	IT	4	987	985	2
Brusa per prerje te metali, betoni	IT	1	1.950	1.553	397
<b>Gjithsejë</b>		<b>9</b>	<b>3.838</b>	<b>3.439</b>	<b>399</b>

#### Tabelë nr. 4 - Struktura e produkteve të rrezikshme që gjenden në treg nën mbikëqyrjen e zgjeruar

Kategoria	Emri i organit që ka kryer kontrollin	Lloji i produktit	Importuar (cope)	Ne treg	I shitur
Pajisje elektrike (drona flutures )	IT	1	10	8	2
<b>Gjithsejte</b>		<b>1</b>	<b>10</b>	<b>8</b>	<b>2</b>

Në tregun e Kosovës nuk u gjinden produkte të rrezikshme të mbuluara nga programi i përgjithshëm i kontrollit të produkteve për vitin 2017, përkatësisht: Veshje për fëmijë (shirita-lidhësa), Lodra për fëmijë (kufizimi i moshës).

## 1.2 Monitorimi reaktivë.

Përveç monitorimit të planifikuar, inspektimet u kryen gjithashtu me mbikëqyrje reaktive të raporteve të RAPEX-it, me njoftim të inspektorit nën mbikëqyrje, me parshtrësë të klientit dhe me kërkesë të Administratës Doganore.

Në monitorimin reaktivë, u identifikuan tetë ( 8) lloje në sasinë prej 3.418 copë të produkteve të rrezikshme: në bazë të raporteve në RAPEX, 5/ lloje në sasi prej 917 copë, me njoftimi nga mbikëqyrja e inspektorit një (1) llojë në sasi prej 8 copë, me parashtrësë të klientit një (1) llojë në sasi prej 1.553 copë, me kërkesë të Administratës Doganore (1) llojë në sasinë prej 940 copë.

Nga numri i mësipërm, shtatë (7) lloje në sasi prej 1.865 copë janë produkte të rrezikshme me rrezik serioz, ndërsa një (1) llojë në sasinë prej 1.553 produkte të rrezikshme që nuk paraqesin një rrezik serioz.

**Tabela nr. 5 -Struktura e produkteve të rrezikshme që gjenden në treg në bazë të njoftimit, publikimit të raporteve nga RAPEX-it**

Kategoria	Emri i organit që ka kryer kontrollin	Lloji i produktit	Importuar (cope)	Në treg	I shitur
Pemë dekorative	IT	4	901	901	-
Vluse elektrike për gatime.	IT	1	16	16	
<b>Gjithsejë</b>		<b>5</b>	<b>917</b>	<b>917</b>	-

**Tabela nr. 6- Struktura e produkteve të rrezikshme që gjenden në treg me njoftim të inspektorit.**

Kategoria	Emri i organit që ka kryer kontrollin	Lloji i produktit	Importuar (copë)	Në treg (copë)	I shitur (copë)
Drona fluturues	IT	1	10	8	2
<b>Gjithsejë</b>		<b>1</b>	<b>10</b>	<b>8</b>	<b>2</b>

**Tabela nr. 7 - Struktura e produkteve të rrezikshme që gjenden në treg me parashtrësë të klientit.**

Kategoria	Emri i organit që ka kryer kontrollin	Lloji i produktit	Importuar (cope)	Në treg	I shitur
Disqe për prerje të metalit dhe betonit	IT	1	1.950	1.553	397
<b>Gjithsejë</b>		<b>1</b>	<b>1.950</b>	<b>1.553</b>	<b>397</b>

**Tabela nr. 8-Struktura e produkteve të rrezikshme që gjenden në treg me kërkesë të administratës doganore.**

Kategoria	Emri i organit që ka kryer kontrollin	Lloji i produktit	Importuar (cope)	Në treg	I shitur
Drita dekoruese	IT	1	940	940	-
<b>Gjithsejë</b>		<b>1</b>	<b>940</b>	<b>940</b>	-

## 2. Produktet e rrezikshme sipas kategorive të rrezikut

### 2.1 Produktet e rrezikshme me rrezik serioz

Në tregun e Kosovës, në monitorimin proaktiv dhe reaktiv, janë gjetur produkte të rrezikshme me rrezik serioz, 8 lloje në sasinë prej 1,886 copë.

Nga sasia e deklaruar, Inspektorati i tregut gjeti 8 lloje në sasinë prej 1,886 copë: pemë dekorative (4 lloj/ 901 copë), drona fluturues (1 lloj/8 copë), kabell vazhduese ( 1 lloj / 21 copë), vluse elektrike për gatime (1 llojë / 16 copë) dhe drita dekoruese (1 llojë / 940 copë). Inspektorati

për Pajisje nën Presion (MZHE), Inspektorati Nacional për Substancat Eksplozive, Substancat e Ndezëshme (MPB), nuk kanë gjetur produkte të rrezikshme në zbatimin e mbikëqyrjes së planifikuar.

## **2.2 Produkte që nuk paraqesin rrezik serioz**

Në tregun e Kosovës, në monitorimin proaktiv dhe reaktiv, u gjetën një (1) llojë në sasinë e 1,553 copë të produkteve të rrezikshme që nuk paraqesin rrezik serioz.

Nga sasia e deklaruar, Inspektorati i tregut gjeti një (1) lloj në sasinë prej 1.553 copë: disqe për prerje të metalit të betoni (1 llojë/ 1,553 copë), Inspektorati për Pajisje nën Presion (MZHE), Inspektorati Nacional për Substancat Eksplozive, Substancat e Ndezëshme (MPB), nuk ka gjetur produkte të rrezikshme që nuk paraqesin një rrezik serioz.

## **3. Masat e marra**

Tërheqja e produktit të rrezikshme me rrezik serioz nga tregu dhe ndalimi përhershëm 8 llojë në sasinë prej 1,886 copë,

Ndalimi i përkohshëm i qarkullimit një (1) llojë në sasinë prej 1,553 copë, produkte të rrezikshme (pa dokumentacion mbështetës) të cilat nuk paraqesin rrezik serioz.

Masa detyruese të shkatërrimit për tetë (8) lloje të produkteve të rrezikshme me rrezik serioz prej 1.886 copë.

**Zëvendës kryesues i Trupit Koordinues**